REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
INSTITUTI I NDËRTIMIT
DREJTORIA E AKT EKSPERTIZAVE DHE PROJEKTEVE


Nr. 1667/5 Prot.

Tiranë, më 06.11.2026


RAPORT PARAPRAK

VËZHGIM NË TERREN PËR VLERËSIMIN E GJENDJES TEKNIKE DHE KONSTRUKTIVE TË OBJEKTIT TË DËMTUAR NGA SHPËRTHIMI DHE ZJARRI, PALLATI NR. 86, ELBASAN

KOORDINATAT: 41°06'30.5"N 20°05'24.5"E



1. VENDNDODHJA E OBJEKTIT



Objekti ndodhet në qytetin e Elbasanit, në rrugën "Emin Haxhiadem Shijaku", Lagjja "Qemal Stafa", nr. 2, Bashkia Elbasan.

Objekti është një ndërtesë banimi 5-katëshe, e cila ka pësuar dëmtime të konsiderueshme si pasojë e shpërthimit dhe zjarrit të ndodhur më datë 04.11.2026, sipas të dhënave të paraqitura në kërkesën zyrtare të Bashkisë Elbasan.

Në vijim të kësaj kërkese, një grup specialistësh të Institutit të Ndërtimit ka kryer inspektimin në terren më datë 05.11.2026, me qëllim evidentimin paraprak të dëmtimeve dhe vlerësimin e gjendjes së sigurisë së objektit.

2. PËRSHKRIMI I OBJEKTIT

2.1. Përshkrimi i Strukturës

Objekti është një ndërtesë banimi 5-katëshe, e ndërtuar sipas teknikave dhe materialeve të përdorura në periudhën e ndërtimit të saj.

Bazuar në konstatimet paraprake të grupit të inspektimit, objekti vlerësohet të jetë ndërtuar rreth viteve 1960–1970, me sistem konstruktiv me muraturë mbajtëse dhe elemente horizontale të realizuara me soleta të parapërgatitura të tipit SAP.

Elementet vertikale mbajtëse përbëhen nga mure me tulla silikate, me trashësi të ndryshme sipas kateve. Sipas vlerësimit paraprak, trashësia e mureve mbajtëse në dy katet e para është rreth 38 cm, ndërsa në tre katet e sipërme rreth 25cm.

Elementet horizontale janë identifikuar si soleta të tipit SAP, të realizuara me elemente të parapërgatitura dhe armaturë çeliku me diametra relativisht të vegjël, karakteristikë e teknologjisë së ndërtimit të asaj periudhe.

Nga vëzhgimi paraprak janë evidentuar disa karakteristika konstruktive që kërkojnë verifikim të mëtejshëm: Cilësia dhe vetitë fiziko-mekanike të betonit dhe çelikut, gjendja e muraturës mbajtëse dhe e llaçit lidhës, mungesa e dukshme e elementeve monolitizuese në disa pjesë të muraturës, mënyra e lidhjes së soletave me muret mbajtëse dhe aftësia e tyre për të siguruar bashkëveprimin hapësinor të strukturës.

Këto karakteristika duhet të verifikohen në kuadër të akt-ekspertizës së thelluar, nëpërmjet investigimeve në terren, testimeve laboratorike dhe analizave konstruktive.

Shoqërues gjatë inspektimit: Bashkia Elbasan.

Data e inspektimit: 05.11.2026

2.2. Përshkrimi i Dëmtimeve

Nga inspektimi vizual i kryer në terren, si dhe nga informacioni paraprak i administruar, rezulton se objekti ka pësuar dëmtime të konsiderueshme si pasojë e shpërthimit dhe zjarrit.

Dëmtime në elementet vertikale. Janë konstatuar shembje të pjesshme dhe të konsiderueshme të mureve në zonat e prekura nga shpërthimi, si dhe dëmtime të muraturës së fasadës së jashtme. Në disa pjesë janë evidentuar çarje, shkëputje dhe humbje e vazhdimësisë së muraturës, të cilat ndikojnë në funksionimin konstruktiv të objektit.

Dëmtime në elementet horizontale. Nga vëzhgimi paraprak janë evidentuar dëmtime dhe çarje në elemente të soletave, të cilat kërkojnë investigim të detajuar për të përcaktuar shkallën e dëmtimit dhe ndikimin në aftësinë e tyre mbajtëse.

Muri perimetral i fasadës dhe soletat, ku ka ndodhur shpërthimi janë shkatërruar plotësisht, konkretisht kati i trete, i katert dhe për këtë arsye soleta e katit të 5, rrezikon shembjen, për arsye se muri mbajtës ku mbështetet soleta, konkretisht muri perimetral i fasadës është shembur, gjithashtu dhe muri paralel me soletat SAP, ka marrë goditje nga shpërthimi ndonse nuk është shembur por krijon mundësinë e një epje përshkak të humbjes së lidhjeve me ndërkatet e kateve përkatëse.

Dëmtime të materialeve ndërtimore. Ekspozimi ndaj temperaturave të larta dhe efektet e shpërthimit kanë ndikuar në vetitë fiziko-mekanike të materialeve përbërëse të strukturës. Për këtë arsye, është i nevojshëm vlerësimi i gjendjes së betonit, çelikut, muraturës dhe materialeve lidhëse në zonat e prekura dhe në zonën e pa dëmtuar gjatë shpërthimit dhe zjarrit.

Dëmtime të elementeve jokonstruktive. Janë evidentuar dëmtime të fasadës, suvatimeve dhe elementeve të tjerë jokonstruktivë, si dhe prani e materialeve të shkëputura dhe mbetjeve ndërtimore, të cilat përbëjnë rrezik për personat që ndodhen pranë objektit.

Duke marrë në konsideratë natyrën dhe përmasat e dëmtimeve të konstatuara, vlerësohet se situata kërkon masa të menjëhershme sigurie dhe një investigim të specializuar konstruktiv.

3. KONKLUZIONE

Bazuar në inspektimin vizual të kryer në terren dhe në konstatimet paraprake të grupit të punës, arrihet në përfundimet e mëposhtme:

1. Objekti ka pësuar dëmtime të konsiderueshme si pasojë e shpërthimit dhe zjarrit, të cilat kanë prekur elemente konstruktive dhe jokonstruktive të ndërtesës.

2. Soleta e katit të 5, mbi zonën ku ka ndodhur shpërthimi rrezikon shembjen nga momenti në moment.
3. Gjendja e konstatuar paraqet rrezik potencial për sigurinë e banorëve dhe të personave që mund të qëndrojnë brenda ose pranë objektit.
4. Rekomandohet përcaktimi dhe zbatimi i një perimetri sigurie 20m-30m, si dhe marrja e masave të nevojshme për shmangien e rënies së elementeve të dëmtuara.
5. Për realizimin e investigimeve të mëtejshme, është i nevojshëm largimi i kontrolluar i mbetjeve të dëmtuara nga zjarri, vetëm pas vlerësimit të sigurisë së ndërhyrjes dhe marrjes së masave të nevojshme mbrojtëse.
6. Pas krijimit të kushteve të sigurta për akses, rekomandohet kryerja e akt-ekspertizës së thelluar, e cila duhet të përfshijë investigimet konstruktive, testimet laboratorike të materialeve dhe analizat përkatëse për vlerësimin e aftësisë mbajtëse dhe qëndrueshmërisë së objektit.

Për realizimin e akt-ekspertizës së thelluar, është i nevojshëm sigurimi i dokumentacionit teknik të objektit, përfshirë dokumentacionin gjeometrik, studimin gjeologjik dhe sizmik, nëse disponohen, si dhe kryerja e investigimeve dhe provave laboratorike përkatëse, sipas kushteve të sigurisë në terren.

Deri në përfundimin e akt-ekspertizës së thelluar dhe përcaktimin e nivelit të sigurisë konstruktive të objektit, rekomandohet ndalimi i përdorimit të godinës dhe kufizimi i aksesit në të, si dhe marrja e masave të nevojshme për garantimin e sigurisë së banorëve dhe personave përreth, në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË INSTITUTI I NDËRTIMIT TIRANË

Grupi i inspektimit në terren:

Ing. Dhimitër PAPA Dhimitri Papa Digitally signed by Dhimitri Papa Date: 2026.11.06 12:01:07 +02'00'

Ing. Mentor FRAHOLLI


Miratoi:

Matilda HAZIZAJ


Data: 05.11.2026

4. FOTO TË OBJEKTIT TË DËMTUAR (1÷24)

1



2




3




4




5



6



7



8



9



10




11



12



13



14



15



16



17




18



19




20




21



22



23



24

